



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDryshe

THIRRJE PËR OFERTË

Video virtuale 3D e muzet të Kalasë së Prizrenit dhe

Dokumentimi i zejes së orëndreqësit (video promovuese)

Programi/projekti “Trashëgimia kulturore për të gjithë: Ruajtja, edukimi, zhvillimi dhe inovacioni”, i cili mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka për qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore në shkollat fillore të qytetit të Prizrenit, me fokus në arsimin e mesëm të ulët, përmes promovimit të nismave dhe aktiviteteve jashtë kurrikulare, të karakterit informues, garues dhe praktikues, me qëllim të nxitjes së ndërgjegjësimit të gjeneratave të reja mbi rëndësinë dhe vlerat e trashëgimisë tonë kulturore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi/projekti, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për **Video virtuale 3D e muzet të Kalasë së Prizrenit dhe Dokumentimi i zejes së orëndreqësit (video promovuese)**.

Video virtuale në 3D duhet të ofrojë informata mbi gjendjen dhe funksionet ekzistuese të të gjitha hapësirave në kuadër të muzeut të Kalasë së Prizrenit, ku duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar i objekti i muzeut me planimetri reale të ndërtesës duke përfshirë inventarin, artefaktet si dhe hapësirën e jashtme të muzeut. Përveç kësaj, duhet të realizohet edhe një video e shkurtër prezantuese për muzeun, e cila do të shërbejë si udhëzues orientues për vizitorët.

Gjithashtu, duhet të realizohen konsultime të rregullta me stafin e muzeut në mënyrë që të dhënat e përdorura të jenë të sakta.

Dokumentimi i zejes së orëndreqësit (video promovuese) do të përqendrohet në një zeje tradicionale, duke dokumentuar procesin e punës dhe historinë e kësaj zeje.

Gjatë realizimit të videove duhet të merren parasysh që kohëzgjatja e videove duhet të jetë minimum 0.45 sec dhe maksimumi 3 minutë; videot duhet të jenë të realizuara në përputhje me specifikat për publikim në Facebook, Tik Tok, Instagram, Youtube dhe website; muzika apo audio e përdorur në video duhet të jetë më të drejta të siguruara; videot të jenë të realizuara në format jo më të vogël se Full HD.

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Fehmi Lladrovci 67, Prizren ~ Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 029-222-771 & 038-224-967

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:
- Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ,
- Çertifikata e numrit fiskal;
- Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së);
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtë të metodologjisë së realizimit të videove duke ofruar së paku informata mbi mënyrën e realizimit, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të videove. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 67, Prizren ose në mënyrë elektronike në apliko@ecmandryshe.org deri më 13.10.2025 ,ora 16:00 me shënim **“Video virtuale 3D e muzet të Kalasë së Prizrenit dhe Dokumentimi i zejës së orëndreqës (video promovuese)”**.

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: apliko@ecmandryshe.org deri më 10.10.2025.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertet/ grupi i ekspertëve/ kompanitë / OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm kompanitë/konsorciumet/OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.

Me respekt,

OJQ EC Ma Ndryshe

029/222 – 771

info@ecmandryshe.org & apliko@ecmandryshe.org